



ÇËSHTJA E PRESIDENTIT, KURTI: DO TA VAZHDOJ DIALOGUN ME OPOZITËN, NUK KEMI NEVOJË PËR ZGJEDHJE TË PËRSËRITURA

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka dërguar ftesa liderëve opozitarë për takime të reja në fillim të javës së ardhshme për çështjen e presidentit. Kurti në një prononcim për medie ka thënë se vendi nuk ka nevojë për zgjedhje të reja, duke theksuar se stabiliteti institucional duhet të jetë prioritet dhe se zgjidhja duhet të gjendet nëpërmjet dialogut me partitë opozitare. Ndaj ftesës së Kurtit kanë reaguar PDK-ja dhe LDK-ja, të cilat kanë thënë se takimet mund të ndodhin vetëm pas vendimit të Kushtetueses



OPINION

DHUNUESIT E SHPRESËS! F. 7

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



ANALIZA NGA CNN: SHTATË ARSYE PSE TRUMPI NUK E KA FITUAR LUFTËN ME IRANIN F. 2

NJË VIT NGA TAKIMI I FUNDIT I THAÇIT ME BABANË E TIJ NË SPITAL F. 6

EKONOMI



DREJTORI I ATK-së: BIZNESET QË NUK PAGUAJNË TATIME DËMTOJNË KONKURENCËN F. 8

KOSOVA THEKSON RËNDËSINË E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË AVANCIMIN E TRANZICIONIT ENERGJETIK F. 8

SPORT



MË 20 MARS PUBLIKOHET LISTA E FUTBOLLISTËVE TË KOSOVËS PËR NDESHJEN KUNDËR SLOVAKISË F. 11



KONGRESISTË DHE SENATORË I KËRKOJNË RUBIOS TA PARANDALOJË KUFIZIMIN E MUNDSHËM TË TRUPAVE AMERIKANE NË KOSOVË F. 3

KOMITETI I RAJONEVE I BE-SË LARGON FUSNOTËN PËR KOSOVËN NGA DOKUMENTET ZYRTARE F. 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kina fuqizon tregtinë e naftës iraniane, por tensionet në Gjirin Persik rrezikojnë furnizimin global

PEKIN, 13 MARS - Në një kohë tensionesh në rritje në Gjirin Persik dhe pasigurie mbi çmimet ndërkombëtare të naftës, Kina po shfaqet si faktor vendimtar në tregun global të energjisë, kryesisht përmes marrëdhënieve të saj energjetike me Iranin. Kina është importuesja më e madhe në botë e naftës bruto

dhe rreth 50 % e importeve të saj detare vijnë nga Lindja e Mesme, me rreth 15 % që vjen nga Irani. Shumica e eksporteve iraniane, midis 80 % dhe 90 %, shkojnë drejt tregut kinez, duke e bërë Kinën një shtyllë kyçe për të ardhurat e ekonomisë iraniane. Rafineritë e pavarura kineze luajnë rol qendror në këtë fluks



tregtar, duke blerë naftë me zbritje nga Irani. Një pikë kyçe për eksportet e

Iranit është ishulli Kharg, nga i cili rreth 90 % e naftës bruto iraniane dërgohet në tregjet ndërkombëtare. Çdo ndërprerje ose sulm ndaj objekteve Kharg do të kishte pasoja të rëndësishme për ekonominë e Iranit dhe tregun global të naftës, duke kufizuar furnizimin dhe rritur presionin mbi çmimet

ndërkombëtare. Në këtë mjedis të brishtë gjeopolitik, Kina ndodhet në një pozitë të veçantë: nga njëra anë është blerësja kryesore e naftës iraniane, nga ana tjetër një faktor që mund të ndikojë, madje edhe në mënyrë indirekte, në ekuilibrin e tregut global të energjisë.

ANALIZA NGA CNN: SHTATË ARSYE PSE TRUMPI NUK E KA FITUAR LUFTËN ME IRANIN

WASHINGTON, 13 MARS - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, po përballlet me një realitet të vështirë në Lindjen e Mesme, ku pas dy javësh konflikti të armatosur, nuk ka mundur të shpallë një fitore të qartë. Sipas analizës së CNN-it, ka të paktën shtatë arsye kryesore pse lufta nuk është fituar ende:

1. Kriza e Ngushticës së Hormuzit
Bllokimi i këtij kanali kyç nga Irani ka penguar eksportin e naftës dhe ka rritur ndjeshëm çmimet. Marina Amerikane nuk mund ta hapë lehtësisht me forcë, duke e bërë këtë një sfidë ushtarake dhe strategjike të vështirë.

2. Pasojat ekonomike dhe mobilizimet ushtarake
Humbjet e personelit amerikan

dhe aksidentet gjatë mobilizimeve tregojnë kostot e larta të luftës, ndërsa tensionet brenda ShBA-së po rriten, me incidente të dhunshme që lidhen me situatën.

3. Kompleksiteti politik dhe diplomatik
Çështjet strategjike kërkojnë zgjidhje politike, jo thjesht ushtarake. Trumpi kërkon dorëzim pa kushte nga Irani, por Teherani refuzon, duke e komplikuar mbylljen e konfliktit.

4. Problemi i udhëheqësit suprem iranian
Vrasja e Ajatollah Ali Khameneit nuk ka çuar në destabilizim të regjimit. Zëvendësimi i tij me Mojtaba Khamenei ka krijuar një udhëheqës më ekstremist, duke

sfiduar narrativën e suksesit.

5. Mosdakordësia e Izraelit
Çdo vendim për t'i dhënë fund luftës duhet ta marrë parasysh pozicionin e Izraelit, i cili ka qëllime strategjike të ndryshme dhe mund të pengojë një marrëveshje të menjëhershme.

6. Çështja bërthamore
Trumpi pretendon shkatërrimin e programit bërthamor të Iranit, por rezervat e uraniumit të pasuruar mbeten dhe mund të ketë ripërprje për ta rinisur programin në të ardhmen.

7. Situata politike e brendshme në ShBA
Rritja e çmimeve të naftës dhe tensionet ekonomike ndikojnë te



qytetarët amerikanë të cilët nuk ndajnë të njëjtën ndjenjë fitoreje si presidenti. Ekspertët nënvizojnë se edhe pse disa operacione ushtarake janë të suksesshme, kompleksi i situatës

politike, ekonomike dhe ushtarake e bën të pamundur shpalljen e një fitoreje të qartë për Trumpin. Lufta mund të zgjasë dhe kërkon fleksibilitet strategjik për të arritur rezultate të qëndrueshme.

UDHËHEQËSI I RI SUPREM I IRANIT DEKLAROHET PËR HERË TË PARË, POR JO ME ZËRIN E TIJ

TEHRAN, 13 MARS - Në një deklaratë të lexuar nga një prezantuese grua në televizionin shtetëror iranian të enjten, udhëheqësi i ri suprem i Iranit, ajatollah Mojtaba Khamenei, djali i liderit të vrarë Ali Khamenei, foli për herë të parë qëkurse u emërua më 8 mars. Megjithatë, Khamenei i ri nuk është parë në publik asnjëherë prej para sulmeve të Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit, të cilat vranë babanë e tij dhe zyrtarë të tjerë iranianë më 28 shkurt. Mojtaba Khamenei tha se Irani do të hakmerret për gjakun e martirëve të tij, do ta mbajë të



mbyllur Ngushticën e Hormuzit dhe do t'i sulmojë bazat amerikane. Ai gjithashtu theksoi se Shtetet e Bashkuara duhet t'i mbyllin të

gjitha bazat e tyre në rajon. Ngushtica, e cila kalon pranë bregdetit të Iranit dhe transporton rreth një të pestën e naftës botërore,

duhet të mbetet e mbyllur për të ushtruar trysni ndaj armikut, tha ai. Lufta që filloi me një fushatë bombardimesh nga ShBA-ja dhe Izraeli në fund të shkurtit deri tani ka vrarë rreth 2 000 njerëz dhe ka shkaktuar atë që Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë e përshkruan si ndërprerjen më të madhe të furnizimit global me energji në histori. Çmimet e naftës u rritën përsëri mbi 100 dollarë për fuçi, pasi kishin rënë më herët gjatë javës kur presidenti amerikan Donald Trump tha se lufta do të përfundonte së shpejti.

Irani ka deklaruar se nuk do ta lejojë kalimin e naftës përmes Ngushticës së Hormuzit, rruga më e rëndësishme e tregtisë energjetike në botë, derisa të ndalen sulmet e ShBA-së dhe Izraelit. Në ditë më herët Trumpi pretendoi se Shtetet e Bashkuara e kanë "fituar" luftën kundër Iranit, por shtoi se forcat ushtarake amerikane do t'i vazhdojnë sulmet derisa të përfundojë e gjithë puna. "Asnjëherë nuk parapëlqehet të thuhet shumë herët se fituam. Ne fituam. Qysh në orët e para", tha Trumpi në një tubim të mbajtur në Kentaki më 11 mars.

ShBA-ja i heq përkohësisht sanksionet për naftën e bllokuar ruse në det

WASHINGTON, 13 MARS - Administrata e presidentit amerikan Donald Trump ka lëshuar një licencë të përkohshme që i lejon vendet të blejnë naftë ruse që ndodhet e bllokuar në det, shkroi të premten në "X" sekretari i Thesarit, Scott Bessent. Ai tha se ky vendim synon të ndihmojë në stabilizimin e tregjeve të energjisë dhe në mbajtjen e çmimeve të ulëta për

shkak të asaj që ai e përshkroi si "kërcënim dhe paqëndrueshmëri të shkaktuar nga regjimi terrorist iranian". Licenca, e publikuar në faqen e internetit të Departamentit të Thesarit të Shteteve të Bashkuara, vlen vetëm për naftën e papërpunuar ruse dhe produktet e naftës që janë ngarkuar në anije deri më 12 mars.



Ajo lejon që këto dërgesa të dorëzohen deri më 11 prill. Një burim diplomatik ukrainas tha se ky është një vendim që sigurisht nuk do të ndihmojë në stabilizimin e tregut, por do ta ndihmojë Rusinë ta zhvillojë

luftën për më gjatë, veçanërisht duke marrë parasysh se vetë Rusia po e ndihmon regjimin iranian ta destabilizojë Lindjen e Mesme. Rusia tha se e cilëson këtë vendim si një përpjekje për t'i

stabilizuar tregjet globale të energjisë. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se Moska beson se interesat e Rusisë dhe të Shteteve të Bashkuara "përputhen bazuar në rrethanat" për këtë çështje, sipas agjencisë ruse të lajmeve, "Interfax". Presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, e kritikoi këtë vendim.

Haradinaj nënshkruan petitionin në përkrahje të bashkëluftëtarëve në Hagë

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka nënshkruar të premten petitionin kombëtar të iniciuar nga kategoritë e dala nga lufta, në përkrahje të bashkëluftëtarëve që po gjykohen padrejtësisht në Gjykatën Speciale në Hagë.

Haradinaj ka thënë se beson se edhe kësaj radhe drejtësia ndërkombëtare do ta rikonfirmojë pastërtinë e luftës sonë të drejtë çlirimtare. “Sot nënshkrova petitionin kombëtar të iniciuar nga kategoritë e dala nga lufta, në përkrahje të bashkëluftëtarëve tanë që

po gjykohen padrejtësisht në Gjykatën Speciale në Hagë. Besojmë se edhe kësaj radhe drejtësia ndërkombëtare do të rikonfirmojë pastërtinë e luftës sonë të drejtë çlirimtare. Rroftë UÇK-ja!”, ka shkruar Haradinaj në rrjetet sociale.



KONGRESISTË DHE SENATORË I KËRKOJNË RUBIOS TA PARANDALOJË KUFIZIMIN E MUNDSHËM TË TRUPAVE AMERIKANE NË KOSOVË

PRISHTINË, 13 MARS - Disa anëtarë të Kongresit Amerikan - nga Partia Republikane dhe ajo Demokratike - i kanë bërë thirrje përmes një letre sekretarit të Shtetit, Marco Rubio, ta parandalojë kufizimin e mundshëm të trupave amerikane në Kosovë, duke thënë se një tërheqje e tillë rrezikon të shkaktojë paqëndrueshmëri jo vetëm në vend, por edhe në rajonin e gjerë të Ballkanit Perëndimor në një kohë të ndikimeve keqdashëse.

Në letër drejtuar Rubios më 11 mars, ata shprehën “shqetësim të thellë” me raportimet se administrata e presidentit Donald Trump mund të tërheqë një pjesë të forcave amerikane nga misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR. “Në një kohë të brishtësisë së shtuar politike dhe të rritjes së ndikimit keqdashës në Ballkanin Perëndimor, një reduktim i parakohshëm i pranisë amerikane rrezikon të destabilizojë jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin më të gjerë, veçanërisht Bosnjë dhe Hercegovinën. Ju bëjmë thirrje të ruani nivelin e forcave amerikane për të mbrojtur interesat e sigurisë kombëtare të ShBA-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor”, thuhet në letër.

Letra e tyre vjen pasi më 19 shkurt gazeta amerikane, “Politico”, duke cituar katër diplomatë të NATO-s, raportoi se Shtetet e Bashkuara po kërkojnë nga aleatët të shqyrtojnë kufizimin e angazhimeve të jashtme të aleancës, përfshirë edhe misionin në Kosovë.

I pyetur për këtë, Pentagoni i tha Radios Evropa e Lirë në një



përgjigje se nuk kishte ndonjë njoftim për ndryshim të dislokimit të forcave.

Rreth 590 forca amerikane shërbejnë në Kosovë si pjesë e misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX. Por, ky mision paqeruajtës, veç tjerash, është përgjegjës për sigurinë në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë, dy vendeve fqinje që vazhdojnë të kenë marrëdhënie të tensionuara.

Kongresistët dhe senatorët thanë tutje në letër se çdo kufizim trupave ushtarake amerikane mund të ketë pasoja të konsiderueshme jo vetëm për kapacitetet operacionale të forcës paqeruajtëse, por edhe të

dobësojë rolin e KFOR-it si pengesë politike në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë.

“Tensionet ndërmjet komuniteteve etnike serbe në veri të Kosovës vazhdojnë mes veprimeve të vazhdueshme nga Qeveria qendrore e Kosovës që vazhdojnë të përkeqësojnë situatën në komunitete. Duke qenë se nuk ka përparim domethënës në dialogun Beograd-Prishtinë, një kufizim i trupave do të hiqte një mjet trysnie që mund t'i detyronte ato rikthimin në bisedime. Për më tepër, një prani e reduktuar amerikane mund të nxisë aktorë që e shohin tërheqjen e Perëndimit si një mundësi për të shkakuar trazira”, thuhet në letër.

Kosova dhe Serbia vazhdojnë të kenë marrëdhënie të tensionuara, posaçërisht prej vitit 2023, kur autoritetet kosovare e

akuzuan Beogradin për një sulm të një grupi serbësh kundër Policisë së Kosovës që la një rreshter të vdekur dhe për një shpërthim në një kanal jetik të ujit.

Serbia e ka mohuar përfshirjen në këto dy sulme që ndodhën në veriun e banuar me shumicë serbe në Kosovë.

Prej atëherë, dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mes dy vendeve fqinje ka ngecur dhe nuk ka pasur asnjë takim të nivelit të lartë, pavarësisht se palët u pajtuan për normalizimin e marrëdhënieve në fillim të 2023-s.

Për më tepër, kongresistët dhe senatorët argumentuan se tërheqja e mundshme amerikane nga KFOR-i mund t'i nxisë aktorët me agjenda nacionaliste në Kosovë dhe Serbi, por edhe ambiciet separatiste të liderëve në

Republikës Sërpska në Bosnje, “duke minuar kohezionin shtetëror në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe duke rritur rrezikun e një krize politike ose të sigurisë”.

Ata përmendën se si Rusia ka kërkuar vazhdimisht të shfrytëzojë përçarjet në Ballkanin Perëndimor dhe të dobësojë mbështetjen e NATO-s dhe BE-së në rajon.

“Në prill 2024, Komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë, Christopher Cavoli, dëshmoi para Kongresit se Rusia po nxit në mënyrë aktive tensione ndërmjet grupeve etnike për të minuar integritetin territorial të Bosnjës, gjë që ndikoi në vendimin e tij për të rritur dhe forcuar KFOR-in në numra dhe për të sjellë më shumë pajisje ushtarake”, thanë ata.

Ata cituan të “dhënat e fundit” nga inteligjenca se nuk ka ndryshim në ndikimin keqdashës rus në rajon, duke thënë se për këtë ShBA-ja “nuk duhet t'i kufizojë trupat amerikane dhe të lërë më shumë hapësirë për aktivitet rus”.

Sa trupa i ka NATO-ja në Kosovë?

Gjithsej 4 767 trupa nga 33 vende të botës shërbejnë aktualisht në Kosovë, në kuadër të misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), KFOR. Gati gjysma e forcave janë nga Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Hungaria dhe Turqia.

Pleurat Sejdiu rizgjedhet kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës

PRISHTINË, 13 MARS - Pleurat Sejdiu është zgjedhur sërish kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK). Sejdiu për këtë pozitë ishte në garë me nënkryetarin e Odës së Mjekëve të Kosovës, Naser Gjonbalaj.

Sejdiu mori 96 vota të anëtarëve të OMK-së, ndërsa kundërkandidati i tij, Naser

Gjonbalaj, mori 26 vota.

Ndryshe në këtë proces morën pjesë anëtarët e Kuvendit të OMK-së, të cilët përmes votimit vendosën për udhëheqjen e re të institucionit që përfaqëson mjekët në Kosovë.

Sejdiu ishte një nga kandidatët për këtë post dhe arriti ta marrë mbështetjen e

shumicës së votave.

Oda e Mjekëve të Kosovës është institucioni që përfaqëson interesat profesionale të mjekëve, mbikëqyr etikën dhe standardet profesionale në shëndetësi dhe bashkëpunon me institucionet për zhvillimin e sistemit shëndetësor në vend.



KOMITETI I RAJONEVE I BE-së LARGON FUSNOTËN PËR KOSOVËN NGA DOKUMENTET ZYRTARE

Komiteti i Rajoneve i Bashkimit Evropian (CoR) ka vendosur ta heqë përdorimin e fusnotës në emrin e Kosovës në dokumentet dhe komunikimet e tij. Në të njëjtin opinion, Komiteti i Rajoneve ka bërë thirrje për heqjen e masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, duke theksuar se këto masa kanë ndikuar drejtpërdrejt në komunat dhe qytetarët e Kosovës. Ky vendim paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm politik dhe institucional për Kosovën në nivel evropian.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 MARS - Komiteti i Rajoneve i Bashkimit Evropian (CoR) ka vendosur ta heqë përdorimin e fusnotës në emrin e Kosovës në dokumentet dhe komunikimet e tij, ka njoftuar Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK).

AKK-ja përmes një njoftimi për medie ka bërë me dije se CoR-i në opinionin e tij më të fundit mbi Paketën e Zgjerimit të BE-së 2025 për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, ka vendosur që në dokumentet dhe komunikimet e tij publike të ndërpritet përdorimi i emërimit Kosovë me fusnotë, dhe të përdoret thjesht Kosovë. “Komiteti i Rajoneve i Bashkimit Evropian (CoR), ka informuar AKK-në se në opinionin e tij më të fundit mbi Paketën e Zgjerimit të BE-së 2025 për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, ka vendosur që në dokumentet dhe komunikimet e tij publike të ndërpritet përdorimi i emërimit ‘Kosovë’ me asteriks*, dhe të përdoret thjesht ‘Kosovë’. Ky vendim vlen për dokumentet dhe komunikimet e Komitetit të Rajoneve, duke e harmonizuar këtë institucion me qëndrimin e kahershëm të Parlamentit Evropian, i cili tashmë përdor emërtimin “Kosovë” pa asteriks në dokumentet e tij zyrtare. Në të njëjtin opinion, Komiteti i Rajoneve gjithashtu ka bërë thirrje për heqjen e masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, duke theksuar se këto masa kanë ndikuar drejtpërdrejt në komunat dhe qytetarët e Kosovës. Ky paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm politik dhe institucional për Kosovën në nivel evropian”, ka njoftuar AKK. Komiteti i Rajoneve ka vlerësuar gjithashtu organizimin e suksesshëm të zgjedhjeve lokale në Kosovë në vitin 2025, duke theksuar se pjesëmarrja e të gjitha komuniteteve ka forcuar legjitimitetin e institucioneve komunale dhe funksionimin e demokracisë lokale. “Në opinionin theksohet se, me rikthimin e pjesëmarrjes demokratike në nivel lokal, arsyet fillestare për vendosjen e masave të BE-së ndaj Kosovës nuk qëndrojnë më, dhe për këtë arsye Komisioni Evropian ftohet që t’i heqë ato sa më parë”, thuhet në njoftimin e AKK-së.

Drejtori ekzekutiv i AKK-së, Sazan Ibrahim, e ka vlerësuar



këtë zhvillim si një lajm shumë të rëndësishëm për Kosovën. “Ky është një lajm shumë i mirë për Kosovën dhe për komunat tona. Është shumë inkurajuese që institucionet evropiane po e njohin rolin e pushtetit lokal dhe ndikimin që vendimet e tyre kanë në jetën e qytetarëve në nivel lokal. Po ashtu, rekomandimi për përdorimin e emrit ‘Kosovë’ pa asteriks është një zhvillim shumë i rëndësishëm në trajtimin institucional të Kosovës në nivel evropian”. Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka thënë se vendimi i Komitetit Evropian të Rajoneve për të hequr nga përdorimi fusnotën krahas emrit të vendit tonë, pra si “Kosovo*”, është një zhvillim shumë i mirë dhe i shumëpritur. “Republika jonë për një kohë të gjatë është përfaqësuar padrejtësisht në organizata ndërkombëtare me një emërtim të tillë jozyrtar, i cili erdhi si rezultat i dialogut të dikurshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Heqja e kësaj padrejtësie përbën një hap të rëndësishëm përpara në fuqizimin dhe afirmimin e

shtetit tonë në arenën ndërkombëtare”, ka shkruar ajo në rrjetet sociale. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka mirëpritur vendimin e Komitetit Evropian të Rajoneve për të ndërprerë përdorimin e emërimit të Republikës së Kosovës me fusnotë në dokumentet dhe komunikimet publike. Ky vendim e harmonizon praktikën e këtij institucioni me emërtimin zyrtar që përdoret nga Parlamenti Evropian, dhe përbën një zhvillim të rëndësishëm institucional në integrimin evropian të Kosovës. Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, shprehu mirënjohje të veçantë për Raportuesen për Zgjerim dhe Kryesuesen e Grupit Punues për Kosovën në kuadër të Komitetit Evropian të Rajoneve, Gillian Coughlan, për mbështetjen dhe angazhimin e saj të vazhdueshëm për Kosovën. Për shembull, ky komitet e përdori fusnotën në emrin e Kosovës së voni, kur në maj 2025 njoftoi në uebsajtin e vet për takime me politikanë lokalë dhe

rajonale nga Shqipëria, Kosova dhe Moldavia, synimi i të cilave ishte përshpejtimi i përgatitjeve për anëtarësim në BE. I themeluar më 1994, Komiteti Evropian i Rajoneve është Asambleja e Bashkimit Evropian e përfaqësuesve lokalë dhe rajonalë. Në uebsajtin e vet, CoR thotë se është zëri i rajoneve dhe qyteteve në BE, dhe se i përfaqëson autoritetet lokale dhe rajonale në të gjithë Bashkimin Evropian dhe jep këshilla për ligje të reja që kanë ndikim mbi rajonet dhe qytetet.

Çfarë është fusnota?

Më 24 shkurt të vitit 2012, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje për përfaqësimin rajonal, që më vonë u bë e njohur si “marrëveshja e fusnotës”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, fusnota do t’i shtohej emrit të Kosovës sa herë që vendi do të përmendej, për ta mundësuar përfaqësimin në konferenca e iniciativa të ndryshme rajonale e ndërkombëtare. “Ky përcaktim

është pa paragjykim ndaj statusit dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për aktin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës”, thuhet në marrëveshje. Në vitet pas nënshkrimit të marrëveshjes, emrit të Kosovës i bashkëngjitej gjithnjë edhe simboli i fusnotës në dokumente të OKB-së, BE-së e institucioneve të tjera ndërkombëtare. Por, së voni, megjithatë, në disa dokumente - si në rezoluta të Parlamentit Evropian, apo në dokumentet e Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi - fusnota nuk e ndiqte emrin e Kosovës. Kosova dhe Serbia nuk kanë bërë hapa për ta zbatuar marrëveshjen e 2023-s për normalizim të marrëdhënieve dhe Beogradi zyrtar vazhdon të mos e njohë pavarësinë e fqinjit. Pavarësinë e saj nuk e njohin as pesë vendet e BE-së: Spanja, Rumania, Qiproja, Sllovakia dhe Greqia. Kosova njihet nga 121 shtete.

GUCATI I JEP MIRËNJOHJE VEPRIMTARIT SALI BISLIMI PËR KONTRIBUTIN NË MBROJTJE TË VLERAVE TË UÇK-së

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, i ka dhënë mirënjohje veprimtarit Sali Bislimi i cili jeton dhe vepron në Zvicër, për kontributin e dhënë në mbrojtje të vlerave çlirimtare dhe udhëheqësve të UÇK-së, të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë. Gucati ka theksuar se Sali Bislimi, përpos angazhimit të madh që ka bërë për të kërkuar drejtësi për ish-presidentin Thaçi dhe çlirimtarët e tjerë, me iniciativa të ndryshme dhe takime me përfaqësues

ndërkombëtarë, ka iniciuar edhe një rezolutë të mbështetur nga 30 deputetë zviceranë, e cila tashmë u është adresuar Dhomave të Specializuara në Hagë. Adresimi i këtij dokumenti përfaqëson një hap simbolik në drejtim të respektimit të standardeve ndërkombëtare të drejtësisë dhe të parimit të një procesi të paanshëm. Gucati ka falënderuar Bislimin për angazhimin e tij në mbrojtjen e vlerave të luftës sonë çlirimtare.



MPJD: NUMËR I KONSIDERUESHËM I KOSOVARËVE JANË KTHYER NGA LINDJA E MESME

PRISHTINË, 13 MARS - Një numër i "konsiderueshëm" i shtetasve të Kosovës janë kthyer në vendlindje nga Lindja e Mesme, por qindra të tjerë vazhdojnë të mbeten në rajonin e përfshirë nga luftimet e ditëve të fundit mes Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit kundër Iranit, tha për Radion Evropa e Lirë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) e Kosovës. Megjithatë, ministria, në një përgjigje të enjten, nuk tregoi numrin e saktë të kosovarëve të kthyer nga ky rajon. Ajo tha se institucionet e Kosovës janë duke u marrë me kërkesat për kthim, në bashkërendim me autoritetet e vendeve përkatëse dhe me partnerët ndërkombëtarë. "Sipas informacioneve më të fundit të pranuar nga misionet tona diplomatike, aktualisht vlerësohet se rreth 600 shtetas të Kosovës vazhdojnë të qëndrojnë



në këto zona", thuhet në përgjigje. Ministria tha se procesi i evakuimit të shtetasve nga Izraeli pritet të përmbyllet deri në fund të këtij muaji. Sipas saj, Ambasada e Kosovës në Riad është duke punuar që të mundësojë kalimin e qytetarëve nga Katari, Kuvajti, Bahrejni dhe Iraku në Arabinë Saudite, duke lehtësuar procesin e pajisjes me viza saudite. "Kjo bëhet me qëllim që qytetarët të mund t'i

shfrytëzojnë fluturimet komerciale drejt Kosovës nga aeroportet në Jedah, Damam dhe Riad. Ndërkohë, Ambasada e Republikës së Kosovës në Katar ka mbuluar transportin rrugor të qytetarëve nga Katari dhe Iraku, në mënyrë që ata të vazhdojnë më tej udhëtimin drejt Kosovës. Në Emiratet e Bashkuara Arabe ndërkohë kanë rifilluar fluturimet komerciale, dhe ambasada jonë atje është duke asistuar qytetarët për të

organizuar kthimin e tyre drejt Kosovës", shtoi ajo. Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli i nisën bombardimet kundër Iranit më 28 shkurt, duke sulmuar caqet e ushtrisë dhe të regjimit klerik. Pas bombardimeve të mëdha fillestare, që lanë të vranë edhe liderin suprem të Iranit, ajatollah Ali Khamenei, Teherani nisi sulme hakmarrëse ndaj Izraelit dhe disa vendeve në Lindjen e Mesme që strehojnë baza ushtarake amerikane, përfshirë Bahrejnin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Kuvajtin, Katarin dhe Arabinë Saudite. Ndërkohë, të enjten, Ambasada e Kosovës në Zagreb njoftoi se në Prishtinë nga Riadi kanë mbërritur edhe disa shtetas të Bosnje e Hercegovinës, por nuk e ka bërë të ditur numrin e tyre. Sipas njoftimit, kërkesa ka ardhur nga Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnjës.

Përmes Aeroportit të Prishtinës ditëve të fundit janë kthyer edhe shtetas të Maqedonisë së Veriut. Shërbimi i Maqedonisë së Veriut i Radios Evropa e Lirë raportoi më 11 mars se një grup prej 153 pasagjerësh është evakuuar nga rajoni i Lindjes së Mesme, derisa autoritetet maqedonase kanë paralajmëruar edhe kthime të tjera. Sipas autoriteteve maqedonase, në mesin e pasagjerëve që janë evakuuar që nga 8 marsi janë edhe 13 shtetas nga Kosova. Shtetas të vet kanë kthyer edhe vende të tjera të rajonit të Ballkanit, teksa nuk dihet se kur mund të përfundojë lufta. Informacione për numrin e kosovarëve që mund të jetojnë në Iran nuk ka, pasi dy vendet nuk kanë marrëdhënie diplomatike. Irani nuk e sheh shtetësinë e Kosovës, për dallim prej shumicës së vendeve të tjera të Gjirit.

MAQEDONCI PËR BLERJEN E RAKETAVE KINEZE NGA SERBIA: SHPËRFAQJE E TENDENCAVE HEGJEMONISTE NDAJ FQINJËVE

PRISHTINË, 13 MARS - Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, i ka thënë të premten Radios Evropa e Lirë se pretendimet e autoriteteve serbe që po armatosen për t'u mbrojtur nga vendet fqinje nuk qëndrojnë, dhe me blerjet e fundit të armëve kineze ato po shpërfaqin tendencat e tyre hegjemoniste në raport me këto vende. Maqedonci i bëri këto deklarata pasi presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, bëri të ditur një ditë më parë se Serbia ka blerë raketa kineze "shkatërruese". Bëhet fjalë për raketat balistike supersonike CM-400 nga Kina. "Blerjet nga Rusia dhe Kina janë bërë që disa vite dhe vazhdojnë të bëhen, pra nuk lidhet me ndonjë kërcënim aktual për Serbinë... asnjë shtet fqinj i

Serbisë në asnjë rast nuk ka shfaqur ndonjë qëllim agresiv apo sulmues në raport me Serbinë", ka deklaruar Maqedonci, duke përmendur se është Serbia ajo e cila shfaq pretendime territoriale ndaj Kosovës. Në një intervistë për Radiotelevizionin e Serbisë, Vučić ka thënë se Serbia i ka integruar me sukses raketat e blera kineze në aeroplanët ushtarakë rusë MiG-29, që veçse i zotëron. "Ne kemi një numër të konsiderueshëm raketash dhe do të kemi edhe më shumë", tha Vučić në një intervistë për Radio Televizionin e Serbisë. Presidenti serb nuk tregoi se sa kushtuan raketat por tha se ato "janë tmerrësisht të shtrenjta. Ne i morëm me një zbritje të vogël". Ministri Maqedonci beson se



blerjet e Serbisë nga Kina janë vazhdimësi e politikës së Vučićit. "Republika e Serbisë blerjet ushtarake kryesisht i realizon nga vendet joanëtare të NATO-s. Kryesisht blerjet strategjike Serbia i ka realizuar nga Federata Ruse dhe Kina. Nga Kina, Ministria e Mbrojtjes së Serbisë

ka prokuruar sistemet raketore kundër-ajrore FK3, HQ-17 dhe HQ-9 si dhe fluturake pa pilot dhe radarë të ndryshëm". Sipas të dhënave të Institutit Ndërkombëtar për Kërkime të Paqes (SIPRI) në Stokholm, në periudhën 2020-2024, Serbia ka importuar më së shumti armë

nga Kina (57%), më pas nga Rusia (20%) dhe nga Franca (7.4%). Ndjaj kësaj blerjeje të Serbisë ka reaguar kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković, i cili paralajmëroi se për këtë çështje do të diskutojë me aleancën e NATO-s. Duke reaguar ndaj deklaratës së Plenkovićit, Vučić tha se "Zagreb nuk do të vendosë se çfarë do të ketë Serbia". Ai tha se Serbia "po përgatitet për mundësinë e sulmit nga aleanca që po formohet nga Prishtina, Tirana dhe Zagreb". Në mars të vitit 2025, Kroacia, Shqipëria dhe Kosova nënshkruan një Deklaratë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të cilën zyrtarët serbë e cilësuan si kërcënim për sigurinë e Serbisë.

DHUNUESIT E SHPRESËS!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

“Mëshira” e dhunuesit: Në vitin 2025 institucionet më të sulmuara në Kosovë nga pushteti autokratik i sundimtarit Kurthi ishin prokuroria, sistemi gjyqësor dhe mediat. Ndërkaq, brutaliteti i sulmit drejtohej fuqishëm kundër Gjykatës Kushtetuese nga të gjithë robtë e mbrapshtë të LVV-së. Në këtë teatër të kukullave penjtë tërhiqeshin nga një agjente greke që fletë dhe shkruan shqip për analfabetët e pushtetit e që është eminenca gri e të gjitha të këqijave që e pllakosën Kosovën në dhjetë vitet e fundit. Kur një pushtet sillet në mënyrë aq banditeske kundër Gjykatës Kushtetuese nënkupton se e kemi prekur fundin, edhe si shoqëri, edhe si shtet! Vallen e dhunimit brutal të Gjykatës Kushtetuese e kanë udhëhequr KM Kurthi, presidentja në largim Vojsa Osmani dhe ministrja e Drejtësisë, Lenka Quko. Pastaj, përmbarimin e ekzekutimit të këtij dhunimi kundër Gjykatës e bënë të mëdhenj përkah budallakia dhe të vegjël përkah dija, integriteti dhe morali, me tituj akademikë dhe diploma të Muçivërcës sikur edhe dijetarë me nam dhe njohës të Kushtetutës si Agim Bahtiri, Edona, Zezona, Matoshka, Donika e Zezë,

pinjollët e Shtimes dhe “analistët” e baustellës nga Gjermania, Amerika, Kazakistani, Kurcistani (Kosova) dhe shumë vende të tjera. Është e pabesueshme se si një vend - Kosova që testi i PISA-s nuk mëshirohet të njehë as si analfabetë, në të njëjtën kohë të ketë aq shumë njohës dhe ekspertë të Kushtetutës! Pasi dështoi zgjedhja e presidentit brenda afateve kushtetuese, presidentja Osmani dekretoi shpërbërjen e Kuvendit dhe shkuarje në zgjedhje të jashtëzakonshme. Nuk jam njohës i Kushtetutës sa Agim Bahtiri dhe Mef Bajçina, si “perla” të ekspertëve të pushtetit autokratik të diktatorit në përpjekje, Albin Kurthi për të dhënë mendimin për këtë mirëpo nuk e kam të qartë se cila do të ishte zgjidhja tjetër pas dështimit të votimit për kandidatin “konsensual” të propozuar nga Kurthi, Glauk Konjufca, nënkryetar i LVV-së dhe zgjatim i Albinit. Lenka Quko ka një kërkesë eksplicite nga Gjykata Kushtetuese; të detyrojë deputetët e Kuvendit të qëndrojnë në sallë dhe ta votojnë kandidatin “konsensual” të Kurthit. E ka ngatërruar gjeografinë duke e

njëjtësuar Kosovën me Korenë e Veriut. Duke bashkëdyzuar Kimin me Binin, si vëllezër ideologjikë! Po ky është kapaciteti i saj; aq din e aq flet! Kjo është pasojë e stresit postraumatik shkaku i rrëzimit në Kuvend 56 herë me radhë. As Majk Tajsoni nuk do të tregonte qëndrueshmëri më të madhe. Ai pasi referi i numëron deri në tetë, mezi mbahet në këmbë kurse Lenka ndonëse ia numëruan 56 herë, është “përsëri në këmbë”. Edhe si kryetare e Kuvendit, edhe si u.d. e presidentes sikur edhe si anëtare e Bordit të Paqes! Lenka nacionale është si qengji i butë; po thithë shumë nëna (poste)! Tash lexues të nderuar e keni të qartë pse Kurthi e propozoi Lenkën 56 herë për kryetare të Kuvendit dhe pse Lenka plotë 56 herë pranoi shembjen e dinjitetit! Për këto ditë!

Nan Rusta: Është një deputet i pushtetit që edhe e shau Gjykatën Kushtetuese por që tani edhe po e mbronnga imperialistët amerikanë dhe revizionistët evropianë! Ua bëri të qartë publikisht Korit diplomatik që: “të trusin bythën e mos të sillen kah Gjykata Kushtetuese...” Pordhë burrash! Menjëherë e përkrahën Blerim Xharrahu dhe El - Pis

Hoxhallari. Tash pason përkrahja e lladikave kushtetues në formë orteku. Po më brengosë heshtja e autoriteteve kushtetuese dhe intelektuale si Gim Bahtiri, Dona Çadra dhe Ana Toshi për këtë çështje me aq rëndësi përshumimin e pandave në Kinë!

Nenad “rrenci”: Më herët Nenad Rashiqi nuk ka qenë djalë i keq. Sa nuk ishte anëtar i LVV-së. Tash, në një intervistë tha se Albin Kurthi vetëm për hatër të tij ia fali 24 hektarë tokë popave të Manastirit të Deçanit! Këtë e vërtetoi edhe Nan Rustemi deputet dhe bashkëpartiak i Nenadit por se u përgënjeshtroi “fuqishëm” nga vuvuzelat e pushtetit që deklaruan se Nenadi e ka ngatërruar krejt këtë punë duke i bërë në një tapinë e tokave të falura “për hatër të Rashiqit dhe brekushet e Atit Porfirije”. Kombinim dhe arsyetim fort logjik.....për budallenjë! Pastaj, për t’i vënë pikë “leshit të Marisë” u kap pas telallit të pushtetit duke pranuar se e ka bërë m.t përmes procesit të për - mut - acionit! Unë nuk shoh asnjë dallim këtu! Njëherë urryese patologjike, përjetësisht e tillë ...deri në ferr: Shvarc Donika është një urryese e

madhe dhe patologjike e UÇK-së, luftës çlirimtare, të burgosurve politikë dhe Bacë Adem Demaçit. Prandaj është bërë yll në LVV. Prandaj është e përkëdhelura e Kurthit. Hashim Thaçi, alfa dhe omega e luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar sikur edhe njëri ndër Baba-llarët e formimit të shtetit të Kosovës, bashkë me çlirimtarët po mbahen peng në Burgun e Hagës, edhe me kontributin shumë bujar të pushtetit aktual ku Shvarc Donika është yll që e errëson të vërtetën dhe e ndriçon gënjeshtren! Hashim Thaçi krijoi vepra kurse Shvarc Donika trashëgoi vepra! Një dallim estetik, praktik dhe faktik! Tash Shvarc Donika e mori fotografinë e presidentit Hashim Thaçi dhe e dërgoi në bodrum të Ministrisë që e kishte shndërruar në Ministri antikombëtare të prostitucionit diplomatik! Fotografinë e Thaçit në bodrum, Thaçin në Hagë! Çfarë deformimi dhe degradimi i trashëgimisë kombëtare! Çfarë shpërfytyrimi i realitetit historik! Po fundi do të jetë kështu; Hashim Thaçi në dhe drejtë historisë, Shvarc Donika drejtë dhe në baustellën e Gjermanisë! Dallim i madh estetik dhe praktik!

NJË VIT NGA TAKIMI I FUNDIT I THAÇIT ME BABANË E TIJ NË SPITAL: NË SPITAL TË THASHË LAMTUMIRË, NGA HAGA TË THEM MIRUPAFSHIM NË PARAJSË!

PRISHTINË, 13 MARS - Të premtën është bërë një vit nga koha kur ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, u lirua përkohësisht nga paraburgimi i Dhomave të Specializuara në Hagë për ta vizituar babanë e tij, Haxhi Thaçin, i cili ndodhej në gjendje të rëndë shëndetësore në spital. Vizita e Thaçit në Kosovë atëherë ishte e shkurtër dhe u realizua nën masa të rrepta sigurie, ndërsa takimi me babanë e tij u konsiderua një moment i rëndë dhe emocional për familjen. Vetëm disa ditë pas kësaj vizite, Haxhi Thaçi ndërroi jetë. “Në spital të thashë lamtumirë, babë!

Nga Haga të them, mirupafshim në parajsë!”, ishte mbishkrimi i kurorës që u dërgua nga Thaçi në ditën e varrimit të Haxhi Thaçit. Ky akt u përjetua me ndjenja të forta edhe nga shumë qytetarë në Kosovë, të cilët e panë moslirimin e Thaçin në ditën e varrimit si akt jonjerëzor nga ana e Gjykatës Speciale. Procesi gjyqësor ndaj ish-kreerëve të UÇK-së në Dhomat e Specializuara në Hagë ka përfunduar dhe tani janë në pritje të vendimit. Gjykata tashmë është tërhequr për ta marrë vendimin përfundimtar, i

cili pritet të shpallet në periudhën në vijim. Në Kosovë pritja për këtë vendim shoqërohet me interes të madh publik, ndërsa shumë qytetarë dhe përfaqësues politikë kanë shprehur besimin e tyre në pafajësinë e ish-udhëheqësve të UÇK-së dhe në karakterin çlirimtar të luftës së saj. Procesi në Hagë ndaj ish-kreerëve të UÇK-së konsiderohet një nga çështjet më të rëndësishme gjyqësore që lidhen me periudhën e luftës në Kosovë, ndërsa vendimi i gjykatës pritet të ketë jehonë të gjerë politike dhe shoqërore në vend.



ÇËSHTJA E PRESIDENTIT, KURTI: DO TA VAZHDOJ DIALOGUN ME OPOZITËN, NUK KEMI NEVOJË PËR ZGJEDHJE TË PËRSËRITURA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 13 mars - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka dërguar ftesa liderëve opozitarë për takime të reja në fillim të javës së ardhshme për çështjen e presidentit. Ndaj këtyre ftesave kanë reaguar PDK-ja dhe LDK-ja. Partia që drejtohet nga Bedri Hamza e ka falënderuar Kurtin për ftesën, por ka theksuar se fillimisht duhet të respektohet procesi institucional dhe të pritët vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me procesin e zgjedhjes së presidentit. Ndërsa kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se do t'i përgjigjet pozitivisht ftesës së Kurtit, por vetëm pas vendimit të Kushtetueses.

Kurti në një prononcim për medie ka thënë se vendi nuk ka nevojë për zgjedhje të reja, duke theksuar se stabiliteti institucional duhet të jetë prioritet dhe se zgjidhja duhet të gjendet përmes dialogut me



partitë opozitare. “Së pari unë kam zhvilluar tri takime me kryetarin e LDK-së dhe dy takime me kryetarin e PDK-së, fatkeqësisht në 48 orët e fundit para se të mbërrinte mesnata e 5 marsit nuk patë asnjë takim, mendoj se ky ka qenë dëm dhe gabim. Është dashur të

takohemi edhe në 48 orët e fundit. Vetëm kur u bë e pamundur figura konsensuale dhe vetëm kur PDK-ja kërkoi që ne t'i sigurojmë votat për të dy kandidatët e saj, pa na i treguar fare emrat neve. Më pak se 30 orë para mesnatës së 5 marsit ne nxorëm emrin e Glauk

Konjufcës, sërish pritëm dhe vetëm 3 orë para mesnatës së 5 marsit e nxorëm dhe emrin e Fatmire Kollçakut. Besoj që me krerët e partive opozitare duhet të takohemi. Qysh sot do t'ju dërgoj ftesa për takim në fillim të javës së ardhshme”, ka thënë Kurti.

Duke komentuar deklaratat e presidentes së vendit, Vjosa Osmani, Kurti ka thënë se nuk dëshiron t'i përsërisë qëndrimet e tij nga konferenca e javës së kaluar, por theksoi se çështja tashmë ndodhet në shqyrtim në Gjykatë Kushtetuese.

Ai ka shtuar se vendi ka kaluar një vit me shumë procese zgjedhore dhe se përsëritja e tyre nuk do të ishte e dobishme. “Unë nuk kam se çfarë të shtoj nga konferenca për medie që ishte para një jave. Nuk besoj se është e nevojshme të përsëris veten. Presidentja e Republikës është kreu i shtetit, unë jam kryeministri i vendit dhe besoj që kemi një çështje që tashmë ndodhet në Gjykatën

Kushtetuese. Theksi duhet të vihet te fakti se në vitin e kaluar kemi pasur katër palë zgjedhje dhe jam i bindur që nuk kemi nevojë ta përsërisim atë të 2025-s. 2026-ta është vit i ri, nuk është as e drejtë, as e dobishme të kemi zgjedhje të përsëritura. Prandaj është e domosdoshme të kemi marrëveshje me partitë opozitare për zgjedhjen e presidentit. Qytetarët e Republikës presin prej neve stabilitet institucional dhe jo zgjedhje të përsëritura. Pra, nuk ka nevojë për zgjedhje të përsëritura. Ka nevojë që sa më parë ta kemi aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të fillojë Kuvendi të punojë”, ka thënë Kurti.

Kryeministri theksoi se bllokimi i punës së Kuvendit ka sjellë vonesa në realizimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke përmendur se mbi 120 milionë euro projekte janë vonuar për shkak të mosfunksionimit të institucioneve.

ARIAN GASHI ZGJEDHET KRYESUES I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 MARS - Prokurori i shtetit, Arian Gashi, është zgjedhur kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës të premtën, duke e mposhtur prokurorin Milot Krasniqi. Gashi u zgjodh me katër vota prej gjashtë të mundshmëve në një votim të fshehtë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Prokurorial.

Ndërsa Dardan Vuniqi u emërua zëvendës i tij.

Gashi e pason Ardian Hajdarajn në këtë post dhe do të jetë kryesues në dy vitet e ardhshme deri kur t'i mbarojë mandati pesëvjeçar si anëtar i Këshillit Prokurorial në janar 2028. Si kryesues ai do të ketë të ketë rol të rëndësishëm për funksionimin e sistemit prokurorial në Kosovë, duke udhëhequr organin që menaxhon dhe duke e mbikëqyr punën e prokurorëve në vend. Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion kushtetues dhe i pavarur që siguron pavarësinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e sistemit prokurorial në vend.

Gashi ka qenë prokuror në Gjykatën e Apelit që nga viti 2021 dhe ka vepruar kryesisht në fushën e krimeve të rënda, krimeve ekonomike, luftimit të korrupsionit dhe edukimit ligjor të profesionistëve të rinj të drejtësisë. Ai ka ngritur aktakuza kundër rasteve të korrupsionit, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Gashi, po ashtu, u ka mbajtur trajnime prokurorëve për përpilim të aktakuzave, ndërkaq ligjëron edhe për tema të ndryshme, si “Uzurpimi i paligjshëm i pronës dhe kthimi i sendeve” në Akademinë e Drejtësisë.

Ish-ministria e Drejtësisë, tani kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se e përshëndet vendimin e Këshillit Prokurorial për ta zgjedhur kryesuesin dhe zëvendësin e tij. “Ky proces shënon një fazë të re për Këshillin Prokurorial dhe dëshmon përkushtimin e institucioneve tona ndaj një sistemi të drejtësisë të pavarur, transparent dhe llogaridhënës”, shkroi Haxhiu në “Facebook”.



Sipas saj, është “inkurajuese të shohim që përpjekjet për ta forcuar rolin e Këshillit Prokurorial dhe për ta rritur besimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë po konkretizohen përmes hapave të tillë institucionalë”.

Lëvizja “Fol” ka përshëndetur përzgjedhjen e Arian Gashit në pozitën e kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), njëherazi ka vlerësuar lart procesin e përzgjedhjes dhe konsideron se funksionimi i mirëfilltë i KPK-së është

thelbësor për integritetin, pavarësinë dhe llogaridhënien e sistemit prokurorial në Kosovë. “KPK ka një rol kyç në garantimin e një sistemi prokurorial profesional, të pavarur dhe efikas. Në këtë drejtim, ‘Fol’-i konsideron se është me rëndësi që KPK të ndërmarrë hapa konkretë për ta forcuar integritetin, llogaridhënien dhe besimin e publikut. Në veçanti është e rëndësishme që të shpallet sa më shpejt konkursi për Kryeprokuror të ri të Shtetit, të

forcohen mekanizmat për vlerësimin e performancës dhe përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve si dhe të rriten transparenca dhe hapja e institucionit ndaj publikut, medieve dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile. Lëvizja ‘Fol’ shpreson që kjo përbërje e re e Këshillit Prokurorial të Kosovës, të shërbejë si një mundësi reale për t'i avancuar reformat dhe për ta rritur besimin e qytetarëve në këtë institucion të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë”, thuhet në komunikatën e Lëvizjes “Fol”.

Sipas raportit të ASK-së: Më shumë të reshura në 2025-n sesa në 2024-n

PRISHTINË, 13 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Statistikave të Ujërave (ASU) për vitin 2025.

Të dhënat e ASU 2025 tregojnë se gjithsej numri i ditëve me të reshura në Prishtinë në vitin

2025 ishte 126 ditë, që krahasuar me vitin 2024 (që ishin 110 ditë), ka një rritje të të reshurave për 14,5 %.

Temperatura mesatare maksimale mujore në vitin 2025 ishte në muajin gusht (40.2°C), ndërsa temperatura mesatare

minimale ishte në muajin shkurt (-12.7°C).

Ndërkaq, temperatura mesatare maksimale vjetore në vitin 2025 ishte 26.3°C, kurse temperatura mesatare minimale vjetore në vitin 2025 ishte (-1.5°C).

Furnizimi i ekonomive familjare

me ujë të pijshëm në Kosovë gjatë vitit 2025 ka shfaqur një trend të lehtë të rritjes.

Në vitin 2025 sasia e ujit të pijshëm arriti deri në 70.2 milion m³/vit, ose një rritje prej 2,3 %, krahasuar me vitin 2024 (ku sasia e ujit për furnizim të



ekonomive familjare ishte 68.6 milionë m³/vit).

KOSOVA THEKSON RËNDËSINË E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË AVANCIMIN E TRANZICIONIT ENERGJETIK

PRISHTINË, 13 MARS - Ministria e Ekonomisë (ME) ka mbajtur takimin e tretë të Komitetit Drejtues të projektit “Tranzicioni i energjisë dhe zbutja e klimës në Kosovë”, i financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor, LuxDev - Luxembourg Development Cooperation Agency. Takimi u hap me një fjalë hyrëse nga ministrija e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, e cila theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetjes së vazhdueshme në avancimin e

tranzicionit energjetik dhe përpjekjeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike në Kosovë. Ajo shtoi se përmes këtij projekti po forcohen kapacitetet institucionale dhe po avancohen politikat që mbështesin zhvillimin e një sistemi energjetik më të qëndrueshëm dhe më të pastër. Në vijim, në fjalën e tij, i ngarkuari me punë i Ambasadës së Luksemburgut në Prishtinë, Eric Dietz, rikonfirmoi përkushtimin e Luksemburgut për të mbështetur Kosovën në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe forcimit të kapaciteteve institucionale në sektorin e energjisë dhe klimës.



Gjatë takimit u miratua rendi i ditës, ndërsa menaxheri i projektit paraqiti përparimin e arritur gjatë vitit 2025 në kuadër të projektit.

Po ashtu, u paraqit Plan i Vjetor Operativ për vitin 2026 si dhe programimi financiar për të njëjtin vit. Pas prezantimeve, pjesëmarrësit

zhvilluan diskutime mbi aktivitetet e realizuara dhe prioritetet për periudhën e ardhshme, duke validuar drejtimet kryesore të zbatimit të projektit për vitin 2026. Takimi u përmbyll me disa rekomandime përfundimtare nga pjesëmarrësit, ndërsa u dakordua që data e takimit të ardhshëm të Komitetit Drejtues të përcaktohet në koordinim ndërmjet palëve. Ky projekt paraqet një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e Kosovës për ta përshpejtuar tranzicionin drejt energjisë së pastër dhe për t'i forcuar politikat për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

PARAQITET DRAFT-ANALIZA PËR AVANCIMIN E PARQEVE INDUSTRIALE ME KARAKTERISTIKA MIQËSORE PËR MJEDISIN

PRISHTINË, 13 MARS - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), përmes Departamentit të Industrisë, ka organizuar një punëtori njëditore për prezantimin e draft-dokumentit “Analiza për avancimin e parqeve industriale me karakteristika miqësore për mjedisin”. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga komuna e Lipjanit, e Rahovecit dhe e Shtimes, së bashku me përfaqësues të institucioneve relevante dhe ministrive të linjës. Studimi është hartuar në kuadër të “Strategjisë për Zhvillim



Industrial dhe Mbështetje të Biznesit (SZHIMB) 2030”, e cila synon të krijojë një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e parqeve industriale moderne dhe konkurruese. Këto parqe pritet të ndërtohen

sipas parimeve të zhvillimit të gjelbër, duke përfshirë qasje në burime të energjisë së rinovueshme dhe me karbon të ulët, sisteme efikase të menaxhimit të mbetjeve dhe modele të ekonomisë qarkore.

Po ashtu, infrastruktura e tyre do të projektohet për ta mbështetur prodhimin e produkteve me emetime të ulëta ose neutrale të karbonit. Një aspekt i rëndësishëm i këtij zhvillimi është edhe promovimi i klasterëve industrialë, të cilët do të nxisin bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet bizneseve vendore, furnizuesve dhe investitorëve të huaj, duke krijuar një ekosistem më të fortë dhe më konkurrues për industrinë. Gjatë punëtorisë ekipi i ekspertëve nga operatori ekonomik INSI ka paraqitur metodologjinë dhe strukturën e analizës, gjetjet kryesore, si dhe

rekomandimet për avancimin e mëtejshëm të parqeve industriale. Analiza fokusohet në zhvillimin e Parkut Industrial në Lipjan, Rahovec dhe Shtime, me synimin që këto hapësira të transformohen në modele moderne të zhvillimit industrial të qëndrueshëm. Në përmbyllje të punëtorisë u theksua se kjo analizë përbën një hap të rëndësishëm drejt transformimit të parqeve industriale në qendra moderne dhe miqësore me mjedisin, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e zhvillimit industrial dhe ekonomik të Republikës së Kosovës.

DREJTORI I ATK-së: BIZNESET QË NUK PAGUAJNË TATIME DËMTOJNË KONKURRENCËN

PRISHTINË, 13 MARS - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Mentor Hyseni, ka theksuar se mosveprimi i institucioneve ndaj bizneseve që shmangin tatimet mund të ndikojë negativisht edhe të bizneset që operojnë në mënyrë të rregullt. Në një diskutim në “Përballje Podcast”, ai tha se konkurrenca jolojale krijon presion mbi bizneset që i përmbushin obligimet tatimore. “Mosveprimi i një institucioni

publik si ATK-ja mund të ndikojë që edhe bizneset e përgjegjshme të bëhen të papërgjegjshme”, tha Hyseni shkruan Telegrafi. Sipas tij, kjo situatë është e dukshme sidomos në rastet kur disa biznese në të njëjtën zonë nuk paguajnë tatimet. “Është tipike te konkurrenca jolojale. Nëse një biznes operon në të njëjtën rrugë, për shembull një kafene apo restaurant, dhe dy të tjera nuk paguajnë, atëherë bie motivimi i atij biznesi që paguan”, deklaroi ai.



Hyseni theksoi se në këto raste krijohet përshtypja se shmangia e tatimeve është mënyra më e lehtë për të mbijetuar në treg. “Thotë se rruga më e mirë është me iu shmang shtetit. Nëse fiton edhe një pjesë të vogël të fitimit,

për disa mund të duket e mjaftueshme”, shtoi ai. Për të adresuar këtë problem, ATK ka nisur një projekt në nivel të gjithë territorit të Kosovës për identifikimin e bizneseve të paregjistruara. “Në këtë aspekt kemi filluar një projekt të përgjithshëm në gjithë Kosovën që e quajmë projekti i stikersave”, tha Hyseni. Sipas tij, përmes këtij projekti identifikohen bizneset e regjistruara dhe ato që operojnë pa regjistrim. “Fillimisht vendosim stikera te bizneset që

janë të regjistruara, për të validuar regjistrimin dhe fiskalizimin e tyre. Pastaj identifikojmë edhe bizneset që operojnë pa regjistrim”, deklaroi ai, shkruan Telegrafi. Hyseni bëri me dije se ATK ka bërë thirrje që bizneset të regjistrohen para fillimit të kontroleve në terren. “ATK fillon me kontrollin në terren në gjithë territorin e Kosovës, regjistroni biznesin dhe mos paguani ndëshkimin prej 500 euro”, tha ai.

Sa karburante dhe produkte të tjera nxirren nga një fuçi naftë?

PRISHTINË, 13 MARS - A e dini se çfarë është një fuçi naftë? Është një njësi matëse dhe një fuçi përmban 159 litra “ari të zi”. Por, sa produkte mund të nxirren nga një fuçi e tillë? Përqindjet ndryshojnë. Pra, nga 159 litra naftë nxirren

gjithsej 170 litra produkte të ndryshme. Nafta e papërpunuar ka shumë molekula të mëdha, e kur ato thyhen në molekula më të vogla, volumi rritet. Produktet përfundimtare zënë më shumë hapësirë se nafta e

papërpunuar që hyn në procesin e rafinimit. Nga këto 170 litra produktesh, 73 litra shkojnë për benzinë, dizeli përbën rreth 40 litra, kerozina 15,5 litra, ndërsa pjesa tjetër është gaz naftë i lëngshëm, asfalt, vajra

petrokimikë dhe të tjerë, koksi, butani... Shumica e produkteve përdoren në industri të ndryshme, kështu që derivatet e naftës mund t'i gjejmë në goma, kozmetikë, lodra, sapun e lente.



DW: SERBIA, IMPORTUESJA NUMËR 1 E SISTEMEVE KRYESORE TË ARMËVE NË RAJON!



Sipas të dhënave nga Instituti Ndërkombëtar i Stokholmit për Studimet e Paqes shpenzimet ushtarake në të gjithë Ballkanin Perëndimor janë rritur. Serbia është importuesja numër 1 e sistemeve kryesore të armëve në rajon. Ndonëse edhe vendet e tjera të rajonit kanë rritur shpenzimet ushtarake, diferenca në volumin e blerjeve mbetet e madhe. Kështu Serbia renditet e 37-ta në botë për importin e sistemeve komplekse të armëve, përpara disa anëtarëve të BE në rajon, si Kroacia dhe Bullgaria. “Rritjen e investimeve në mbrojtje në mënyrën më të dukshme dhe në një kohë më të gjatë e vërejmë në Serbi, ku gjatë dekadës së fundit është krijuar presion për të rinovuar armatimet e trashëguara nga JNA (Ushtria Popullore Jugosllave) dhe lidhshimi politik e ka kuptuar vlerën politiko-simbolike. Tensionet me Kosovën ndoshta kanë inkurajuar më tej mendimin, se një arsenal më i fortë është një as i mirë në negociatat me aktorët ndërkombëtarë”, shpjegon për DW Katarina Gjokiç, hulumtuese në SIPRI. Krahas vëllimit më të madh të importeve të armëve, Serbia ka edhe shpenzimet më të mëdha të mbrojtjes në rajon. Në periudhën 2020-2024 vlera reale e buxhetit ushtarak ishte rreth gjashtë herë më e lartë se ajo e Shqipërisë, që është vendi i dytë për shpenzimet ushtarake në Ballkanin Perëndimor. Presidenti serb Aleksandar Vučić

njoftoi së fundmi se vendi i tij për një vit e gjysëm do të dyfishojë kapacitetin ushtarak. Për analistin ushtarak Aleksandar Radiç ky nuk është një trend i ri. Ai kujton se intensifikimi i armatimit ka nisur në vitin 2016, kur, siç thotë ai, Vučić njohu potencialin politik dhe ekonomik të prokurimit të armëve. “Blerja e armëve shpesh bëhet nga motive politike. Ndonjëherë të krijohet përshtypja se vetë ushtria befasohet me ato që merr, sepse së pari kihet parasysh nga kush blihet dhe jo çfarë blihet”, thotë Radiç. “Nëse Vučić shkon në Pekin, mund të pritët për shembull, që pas kësaj të fillojnë negociatat për prokurimin e pajisjeve ushtarake nga Kina”, shton ai.

Furnizues nga të gjithë anët e botës

Sipas të dhënave të SIPRI-t në pesë vitet e fundit Serbia ka importuar sisteme komplekse armësh nga 13 vende të ndryshme. Furnizuesi më i madh ishte Kina, kryesisht falë blerjes së sistemeve të mbrojtjes ajrore me rreze të mesme, ndërsa donacionet më të mëdha erdhën nga Rusia dhe Bjellorusia. Megjithatë kjo strukturë së shpejti mund të ndryshojë, thotë studiuesja e SIPRI, Katarina Gjokiç. Nëse zbatohen kontratat tashmë të nënshkruara, Franca dhe Izraeli mund të bëhen furnizuesit kryesorë të Serbisë. “Për mua kjo shumëllojshmëri furnizuesish flet për dy gjëra: së

pari Serbia nuk ka një aleat ushtarak dhe së dyti ka para dhe gatishmëri të mjaftueshme, për të marrë kredi për sistemet më të shtrenjta të armëve, gjë që e bën atë një klient tërheqës për eksportues të ndryshëm”, thotë Gjokiç për DW.

Turqia dhe SHBA janë partnerë kryesorë të vendeve të tjera në rajon

Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor shënojnë një vëllim dukshëm më të ulët të importeve të armëve. Shqipëria është e dyta në rajon, por është në vendin e 103-të në botë, me importe që sipas SIPRI-t janë rreth gjashtë herë më të ulëta se ato të Serbisë. Kosova renditet e 118-ta, Maqedonia e Veriut e 138-ta, Bosnja dhe Hercegovina e 144-ta dhe Mali i Zi i 152-ti në mesin e gjithsej 166 destinacioneve të armëve komplekse në botë. “Vendet e NATO-s në rajon reagan kryesisht ndaj presionit nga mandati i parë i Trump për rritjen e shpenzimeve ushtarake dhe investimeve në pajisje ushtarake. Pas invazionit të plotë të Ukrainës nga Rusia mund të vërehet një rritje shtesë e porosive për armë”, shpjegon Gjokiç. Në Bosnje dhe Hercegovinë shihet megjithatë një tendencë tjetër. “Nuk vërejmë rritje të ndjeshme të investimeve në ushtri, por më shumë investohet në pajisjet e policisë, gjë që mund të ndikojë në perceptimin e kërcënimit mes dy subjekteve,

duke pasur parasysh mënyrën se si është organizuar policia”, shton ajo. Shumica e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor tradicionalisht mbështeten tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqia si furnizuesit dhe donatorët kryesorë të pajisjeve ushtarake. Blerje të tilla shpesh shërbejnë edhe për të forcuar marrëdhëniet politike me aleatët e NATO-s. “Me rritjen e shpenzimeve të planifikuara ushtarake, rajoni bëhet një treg interesant për eksportuesit e tjerë të armëve, në radhë të parë për Francën, nga e cila disa vende presin dërgesa të sistemeve të ndryshme”, thotë Gjokiç. “Dhe marrëdhëniet dypalëshe mes Shqipërisë dhe Italisë janë gjithashtu interesante – Italia i ka dhuruar tashmë Shqipërisë një varkë patrullimi, dhe në periudhën e ardhshme do të jetë përgjegjëse edhe për dërgimin e automjeteve të lehta të blinduara, që financohen nga Bashkimi Evropian.

Rrahja e gjoksit

Nga ana tjetër, Katarina Gjokiç thekson se vëllimi i përgjithshëm i armëve të blera në rajon mbetet ende relativisht modest krahasuar me botën. “Kur nga zero blerje merr disa sisteme të reja, kjo mund të duket dramatike. E kombinuar me retorikën luftarake të elitave politike dhe raportimet sensacionale krijon një ndjenjë

pasigurie të fqinjët dhe shpesh shërben si justifikim për investime të reja në armatime”, thotë Gjokiç për DW. Një retorikë e tillë ushqehet më tej nga marrëveshjet e nënshkruara së fundmi për bashkëpunimin ushtarak – midis Serbisë dhe Hungarisë, si dhe ndërmjet Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës – të cilat liderët politikë shpesh i paraqesin si aleanca të reja ushtarake. “Në Shqipëri ekzagjerohet rreziku serb, ashtu si në Serbi politika ekzagjeron rrezikun nga të gjithë rreth nesh. Është një kombinim i politikës dhe i propagandës, që justifikon marrëveshjet e armëve. Kroacia dëshiron një rol të veçantë në rajon, veçanërisht në raport me Serbinë, ndërsa vendet e tjera ndjekin kryesisht trendin më të gjerë rajonal”, vlerëson Radiç. Radiç dhe Gjokiç janë të një mendimi se marrëveshjet e lartpërmendura nuk mund të konsiderohen si aleanca të vërteta ushtarake. “Këto marrëveshje kryesisht kanë të bëjnë me stërvitjet, stërvitjet të përbashkëta ushtarake dhe koordinimin e aktiviteteve, që në masë të madhe do të zhvilloheshin gjithsesi brenda strukturave të NATO-s”, shpjegon Gjokiç. Në rrethana të tilla, shton Gjokiç, NATO mbetet faktori kryesor parandalues në rajon, megjithëse roli i saj i ardhshëm do të ndikohet nga dinamika më e gjerë brenda vetë aleancës./DW



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

MË 20 MARS PUBLIKOHET LISTA E FUTBOLLISTËVE TË KOSOVËS PËR NDESHJEN KUNDËR SLLOVAKISË

PRISHTINË, 13 MARS - Përzgjedhësi i Kosovës, Franco Foda, pritët që më 20 mars ta bëjë publike listën e futbollistëve të grumbulluar për ndeshjen shumë të rëndësishme ndaj Kombëtares së Sllovakisë. Përballja ndërmjet Kosovës dhe Sllovakisë do të zhvillohet më 26 mars në Bratislavë dhe vlen për gjysmëfinalen e “play-off”-it kualifikues për Kupën e Botës 2026. Kjo listë konsiderohet ndër më të rëndësishmet e Fodës që nga marrja e drejtimit të Kombëtares së Kosovës, pasi

“Dardanët” ndodhen vetëm dy ndeshje larg realizimit të një kualifikimi historik në Botëror. Fituesi i këtij takimi do ta sigurojë finalen e “play-off”-it, ku do të përballët me fituesin e ndeshjes në mes të Kombëtares së Turqisë dhe Kombëtares së Rumanisë. Ndeshja finale zhvillohet më 31 mars, e nëse kalojmë ne, atëherë do të zhvillohet në “Fadil Vokrri”. Sa i përket listës, nuk priten ndryshime të mëdha krahasuar me grumbullimet e mëparshme. Kosovës zyrtarisht do t’i mungojë

kapiteni Amir Rrahmani për shkak të një lëndimi. Ndërkohë, Ilir Krasniqi pritët të jetë në dispozicion pavarësisht një dëmtimi të pësuar disa ditë më parë. Mungesë pritët të jetë edhe sulmuesi i Rubin Kazanit, Dardan Shabanhaxhaj, i cili ishte i ftuar për herë të parë, por është i lënduar dhe nuk do të mund ta ndihmojë ekipin. Kombëtarja e Kosovës do ta nisë grumbullimin më 23 mars për ndeshjen ndaj Sllovakisë.



NDESHJA E SEZONIT NË SUPERLIGË LUHET NË MES TË BALLKANIT DHE DRITËS



PRISHTINË, 13 MARS - Xhironja e 24-të e Superligës së Kosovës na jep një javë me emocione ku sytë do të jenë të derbi kryesor i javës, Ballkani kundër Dritës, e cila mund të vendosë se a do të rihapet gara për titull apo jo. Skuadra e Ballkanit gjendet në pozitën e dytë me 39 pikë, kurse Drita është në pozitën e parë me 42 pikë. Në rast të një fitoreje të Ballkanit do të rihapet gara për

titull, kurse sa i përket luftës për mbijetesë skuadra e Ferizajt i shkon si mysafir skuadrës së Malishevës, e cila po lufton për të marrë pjesë në garat evropiane. Skuadra e Nevil Dedes ka tri humbje, një barazim dhe vetëm një fitore në 5 ndeshjet e fundit. Kurse Prishtina e pret Prishtinën e re në kuadër të xhiros së 24-t dhe pret ta shfrytëzojë gabimin eventuale të Ballkanit ose Dritës

për t’u futur në garë për titull. Dukagjini e pret Llapin në ndeshje direkte e cila synon fitoren për t’u afruar skuadrave për luftën në garën evropiane, kurse Llapi i Tahir Batatinës kërkon fitore për t’u larguar nga zona e rrezikshme. Kurse Drenica e cila gjendet në pozitën e fundit i shkon Gjilanit si mysafir. Gjilani me një fitore do t’i afrohej zonës që i dërgon në gara evropiane.

ALBIMALL SUPERLIGA -
JAVA 24

Sot (e shtunë)
13:00 Gjilani – Drenica
13:00 Prishtina – Prishtina e Re
13:00 Malisheva Ferizaj

Nesër (e diel)
13:00 Ballkani – Drita
13:00 Dukagjinin - Llapi

NËNKAMPIONI BASHKIMI SFIDON KAMPIONEN TREPÇËN



PRISHTINË, 13 MARS - ProCredit Superliga e Kosovës në basketboll vazhdon me ndeshje interesante këtë fundjavë. Superderbi do të zhvillohet nesër (e diel) ndërmjet nënkampionit Bashkimit dhe kampiones Trepçës, njëherësh edhe vendi i dytë kundër vendit të parë. Këto dy skuadra janë përballur edhe në dy finale të fundit të Kupës, ku kanë fituar “Xehetarët”. Në elitën e basketbollit, prizrenasit janë në vendin e dytë me 16 fitore e shtatë

humbje, kurse mitrovicasit 21 fitore e tri humbje, duke regjistruar 15 fitore radhazi. Kjo sfidë pritët të jetë interesante para “play-off”-it, që këtë edicion pritët të jetë i jashtëzakonshëm. Ndeshje shumë me rëndësi do të jetë ajo në mes Vëllaznimit dhe Golden Eagle Yllit, me kuqezinjtë që kanë tetë fitore e 15 humbje, kurse therandasit dhjetë fitore e 13 humbje. Një përballje gjithashtu interesante është ajo ndërmjet Sigal Prishtinës

dhe Rahoveci 029. Prishtinasit numërojnë nëntë fitore e 14 humbje, kurse ‘Vreshtarët’ shtatë fitore e 16 humbje. Nesër (e diel) do të ndeshen GO+ Peja me Borën. Pejanët kanë dhjetë fitore e 13 humbje, derisa prishtinasit 12 fitore e 11 humbje. Kampionati po hyn në fazën e fundit, ku çdo ndeshje është vendimtare dhe skuadrat po luftojnë në maksimum për synimet që i kanë.

PROCREDIT SUPERLIGA -
JAVA 24

Sot (e shtunë)
20:00 Vëllaznimi - Golden Eagle Ylli
20:00 Sigal Prishtina - Rahoveci 029

Nesër (e diel)
19:30 GO+ Peja - Bora
19:30 Bashkimi - Trepça

20 PORTIERËT MË TË MIRË NË BOTË PËR VITIN 2026

MADRID, 13 MARS - Roli i portierit në futbollin modern nuk ka qenë kurrë kaq vendimtar. Një skuadër që synon trofe të mëdhenj nuk mund të shkojë shumë larg pa një portier të jashtëzakonshëm, një “gardian” i cili jo vetëm ndalon çdo goditje drejt portës, por edhe ndihmon skuadrën të ndërtojë lojën nga prapa. Në epokën e futbollit modern portierët nuk janë më vetëm mbrojtës të vijës së fundit, por edhe liderë që zotërojnë lojën me topin në këmbë dhe veprojnë si

“portierë të lirë që luajnë si mbrojtës në vijën e fundit” kur situata e kërkon. Fuqia e një portieri të madh mund ta ndryshojë fatin e një skuadre, duke e transformuar nga një ekip mesatar në një konkurrent të frikshëm për tituj. Siç e kemi parë në vitet e fundit me Alisson Becker të Liverpool apo Ederson të Manchester City, një portier i nivelit të lartë mund t’i japë skuadrës besimin dhe sigurinë që i duhen për të shkuar deri në nivele të jashtëzakonshme

suksesit. Kjo listë përfshin 20 portierët më të mirë në botë për vitin 2026, duke u bazuar në paraqitjet e tyre me klubet, përfaqësueset kombëtare, numrin e ndeshjeve pa pësuar gol, ndikimin në ekip, aftësinë për të shpëtuar goditje të rrezikshme dhe talentin për t’i nisur sulmet nga prapa. Nga talente të reja që po lulëzojnë, deri te legjendat që vazhdojnë të dominojnë në nivele të larta, këta portierë janë të gatshëm për çdo sfidë dhe janë shtylla e ekipeve të tyre.

RENDITJA E PORTIERËVE
MË TË MIRË NË BOTË (2026):

1. THIBAUT COURTOIS - REAL MADRID

2. DAVID RAYA - ARSENAL

3. GIANLUIGI DONNARUMMA - MANCHESTER CITY

4. ALISSON BECKER - LIVERPOOL

5. JOAN GARCIA - BARCELONA

6. YANN SOMMER - INTER

7. JAN OBLAK - ATLETICO MADRID

8. MIKE MAIGNAN - AC MILAN

9. MANUEL NEUER - BAYERN MUNICH

10. EMILIANO MARTINEZ - ASTON VILLA

11. MILE SVILAR - AS ROMA

12. GREGOR KOBEL - BORUSSIA DORTMUND

13. JORDAN PICKFORD - EVERTON

14. SENNE LAMMENS - MANCHESTER UNITED

15. UNAI SIMON - ATHLETIC BILBAO

16. ROBIN ROEFS - SUNDERLAND

17. DIOGO COSTA - FC PORTO

18. LUCAS CHEVALIER - PARIS SAINT-GERMAIN

19. MICHELE DI GREGORIO - JUVENTUS

20. GIORGI MAMARDASHVILI - LIVERPOOL

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin “FERPLAST” SH.P.K. Ferizaj, kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore, sipas kopjes fizike me Nr.Prot. 25/8264/MMPHI/705/DMM, për veprimtarinë: Prodhim i tubave të plastikës, Talinoc i Jerlive, Ferizaj, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 10.04.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e kuvendit komunal te komunes se Ferizajit do të organizohet debat publik nga operatori “FERPLAST” SH.P.K. Ferizaj, kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore, sipas kopjes fizike me Nr.Prot. 25/8264/MMPHI/705/DMM, për veprimtarinë: Prodhim i tubave të plastikës, Talinoc i Jerlive, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

<https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=dAFk8wyqrcGJk62TC60ZQRNyqoJzhk>

Meeting ID :9535257790

Pascode: 000000

Linku i Komunës së Ferizajt:

<https://ferizaj.rks-gov.net/>

Linku i gazetës ditore:

<http://www.epokaere.com/>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=Ferplast>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

“FERPLAST” SH.P.K.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “FERPLAST” SH.P.K., Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën për prodhimin e tubave të plastikës (PP, HDPE) në Babush të Muhaxherëve Serbëve (Salishtë), Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 16.04.2026 në ora 10:00 në Hapsirën Komunës së Ferizajt, do të organizohet debat publik nga “FERPLAST” SH.P.K., Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/9535257790?pwd=dAFk8wyqrcGJk62TC60ZQRNyqoJzhk>

ID(PMI) 9535257790
Pascode: 000000

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “FERPLAST” SH.P.K., Ferizaj, për Pëlqim Mjedisor, për Fabrikën për prodhimin e tubave të plastikës (PP, HDPE) në Babush të Muhaxherëve Serbëve (Salishtë), Ferizaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

<vnm.komente@rks-gov.net>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Kryeshefes Ekzekutive të datës 13.03.2026 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 13.03.2026 të shpall:

KONKURS TE BRENDSDHEM

Kontabilist i Aseteve dhe Shpenzimeve-, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 13-03-110

Përgatitja profesionale: Fakulteti Ekonomik

Përvoja e punës: 3 vite përvojë pune profesionale

Lartësia e pagës mujore: 555.97 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheqë mjetet themelore (asetet) dhe inventarin, faturat blerëse (shpenzimet);
- Përcjellë gjendjen e furnitorëve dhe rregullimin e kartelave analitike , materiale dhe financiare ;
- Udhëheqë (regjistron) depotë si dhe barazimin e tyre së paku një herë në fund vit duke konstatuar gjendjen e tyre materiale dhe financiare, si dhe punë të tjera të kësaj natyre, të cilat i përcakton eprori i drejtëpërdrejtë.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe ne bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës se rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- CV-ja
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Dëshmi për përvojën e punes (Trustin)
- Kopja e leternjoftimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykatata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muajt).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 14.03.2026 deri me 28.03.2026, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr."Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valon Thaqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Haxhi Hoti” Rogovë Gjakovë nga kl. 1-5.

- Milihat Tahiraj shpall të pavlefshme dëftesën e plot sh.f.m.u. “Ukshin Miftari” Skivjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- Besim Elshani shpall të pavlefshme certifikatat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Buzuku” Prizren.

- Muhamet Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Drenica" Polac.

- Sadete Bajrami shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta" Prekaz.

- Fidan Peci shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 5-të të shkollës "Musa Hoti".

- Suna Haxhani shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

- Suzana Halimi shpall të pavlefshme dëftesën e vitit 4-të dhe diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi".

- Neriman Mujka shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Frang Bardhi" Mitrovicë.

- “Magma Gaming Center” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812029016.

- “Blue’ IM 01” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812006907.

- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

Zejnije Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

